

Procedura standarde e matjes së TA-së	
Hapat kryesorë për matjen e duhur të TA-së	Udhëzime specifike
Hapi 1: Përgatiteni pacientin siç duhet	1. Kërkojini të qetësohet, të ulët në karrige (këmbët në dysheme, kurrizin e mbështetur) për > 5 min. 2. Pacienti duhet të shmangë kafeinën, ushtrimet fizike dhe duhanpirjen për të paktën 30 min përpara matjes së TA-së 3. Sigurohuni që pacienti ta ketë zbrazur fshikëzën. 4. As pacienti, as vëzhguesi nuk duhet të flasin gjatë periudhës së qetësimit ose gjatë matjes. 5. Hiqni të gjitha shtresat e rrobave që mbulojnë zonën ku do të vendoset mansheta. 6. Matjet e bëra teksa pacienti qëndron ulur ose shtrirë në një shtrat ekzaminimi nuk i plotësojnë këto kritere.
Hapi 2: Përdorni teknikën e duhur për matjen e TA-së	1. Përdorni një pajisje matëse të TA-së që është validuar dhe siguron që pajisja kalibrohet në mënyrë periodike. 2. Mbështeteni krahun e pacientit (p.sh. duke pushuar mbi një tavolinë). 3. Poziciononi mesin e manshetës në pjesën e sipërme të krahut të pacientit në nivelin e atriumit të djathtë (pika e mesit e sternumit). 4. Përdorni madhësinë e duhur të manshetës, në mënyrë që ajo të rrethojë 80% të krahut. Vëreni nëse po përdorni manshetë më të madhe ose më të vogël se normalja. 5. Për matjet auskultative mund të përdoret ose diafragma ose këmbana e stetoskopit.
Hapi 3: Kryeni matjet e duhura për diagnostikimin dhe trajtimin e TA-së/ hipertensionit të rritur	1. Në vizitën e parë, regjistroni TA-në në të dy krahët. Përdorni krahun që jep matjen më të lartë për matjet vijuese. 2. Ndajini matjet e përsëritura me 1-2 min. 3. Për matjet auskultative, palponi zhdukjen e pulsit radial për të vlerësuar TAS-në. Fryni manshetën 20-30 mmHg mbi këtë nivel për përcaktimin auskultativ të nivelit të TA-së. 4. Për matje auskultative, shfryni presionin e manshetës 2 mmHg në sekondë dhe dëgjoni tinguj Korotkoff
Hapi 4: Dokumentoni matjet e sakta të TA-së në mënyrën e duhur	1. Regjistroni TAS-në dhe TAD-në. Nëse përdorni teknikën auskultatore, regjistroni TAS-në dhe TAD-në si fillimin e tingullit të parë Korotkoff dhe zhdukjen e të gjithë tingujve Korotkoff, përkatësisht, duke përdorur numrin më të afërt çift. 2. Vëreni kohën e marrjes së barnave më të fundit për TA-në përpara matjeve.
Hapi 5: Mesatarja e matjeve	Përdorni mesataren e 2 matjeve të kryera në ≥2 raste për të vlerësuar nivelin individual të TA-së.
Hapi 6: Bëjini të ditur pacientit matjet e TA-së	Bëjini të ditur pacientit matjet e TAS-së/ TAD-së, me gojë dhe me shkrim.

Shkurtesa: TA -tensioni arterial; TAD-presioni diastolik i gjakut; TAS-Tensioni Arterial sistolik